



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr.735/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit M.M, sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.871/16 të dt.24.8.2016 për shkak të veprës penale: lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 lidhur me nën par 1.4 të KPRK-së. pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit M. M dhe të prokurorit të shtetit Ardita Beqiraj me dt.05.7.2017 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri M. M i lindur me dt..... në fsh., me vendbanim në, i biri i M dhe nënës e D e gjinisë R, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës , më parë i pa dënuar, gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se:

Me dt. 01.4.2016, rreth orës 08:20 minuta, në në rrugën , në shtëpinë e tyre i pandehuri me dashje i shkakton lëndime trupore të dëmtuarës –bashkëshortes së tij T. M , në atë mënyrë që i pandehuri pasi zgjohet nga gjumi fillon të fjaloset me bashkëshorten e tij këtu të dëmtuarën, ku fillon që ta ofendoj me fjalët “kurvë” ku me pas e kap ushtron dhunë fizike , ku fillimisht e kap për flok duke e shtyrë për muri , e tëra kishte ndodhur për shkak të dyshimeve që i pandehuri kishte për bashkëshorten e tij , ku si pasojë e kësaj, ku si pasojë e kësaj të njëjtë i shkakton lëndime të lehta trupor.

-me çka ka kryer vepra penale : lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 lidhur me nën par 1.4 të KPRK-së.

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 49, 50,51,52, dhe nenit 188 par 1 lidhur me nën par 1.4 të KPRK-së. **I SHQIPTON.**

DËNIM TË KUSHTËZUAR

Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 3 muaj, e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

I pandehuri për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i paushallit gjyqësorë.

E dëmtuara për realizimin eventual e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.24.08.2016 kundër të pandehurit M. M ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.871/16 , për vepër penale : lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 lidhur me nën par 1.4 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singhtë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme ,gjendjen e vështirë ekonomike, dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 453 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë. 05.7.2017.

Sekretarja juridike
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari
Sejdi Blakaj

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë
E përmes kësaj Gjykate .